



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kačanik/Municipality of Kačanik

Zyra e Kryetarit



01Nr.400 01-16234/25

Kaçanik,23.07.2025

Procesverbal nga Konsultimi buxhetor për projekt buxhetin 2026-2027 me te rinj

Vendi: Shtëpia e Kulturës Kačanik

Ora 13:00

Data: 23.07.2025

Planifikimet buxhetore diskutohen edhe me të rinjtë e komunës sonë

Në vazhden e konsultimeve buxhetore, të rinjtë nga komuna jonë ishin pjesë e këtyre diskutimeve. Në fjalën e tij Nënkyetari Sabedin Vishi tha se përkrahja e komunës për aktivitetet rinore çdo herë ka qenë, e në veçanti për të rinjtë nga KVRL, të cilët kanë treguar kulturë organizative në aktivitete të ndryshme. Nënkyetari tutje tha se nga viti në vit janë rritur subvencionet për kulturë, rini e sport si dhe për bursa të studentëve. Poashtu janë financuar edhe projektet kapitale si ato kulturore, arsimore e sportive. Të rinjtë u ndanë të kënaqur me përkrahjen e komunës, ndërsa kërkuan rritje të investimeve kapitale për të rinjtë si dhe rritje të subvencioneve.

Kanita Berisha- Deri tash kush ka bërë më shumë projekte që ja ka vlejte edhe subvencionit I dhënë,

Natyrë Berisha- Nëse hapet klubi i Gollfit a mbështetet me subvencione nga komuna

Të gjithë ata që parashtruan kërkesat e tyre morën përgjigje në mënyrë të përgjithshme nga Nënkyetari i Komunës, ndërsa ditëve në vijim do të përgatitet edhe raporti me të gjitha përgjigjet për secilën kërkesë.

Takimi përfundoi në ora 14:10.

Procesmbajtëse

Hartume Guri Selimi

